

**DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS**

**POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU**

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2008/4 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) dhe në pajtim me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr.2008/6 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr.2006/17, zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/13 për Themelimin e Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit,

Duke ndryshuar dhe zëvendësuar Rregullat për themelimin Trupit Gjykues dhe Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, për ndarjen e lëndëve dhe rregulloren e plotësuar të punës, të miratuar nga DHPGJS-ja më 24 shkurt 2009,

Duke marrë parasysh që Presidiumi, i paraparë në dokumentet e lartpërmendura, ende nuk është themeluar,

Duke u bazuar në pajtimin e shumicës së gjyqtarëve të emëruar dhe tashmë të përcaktuar të DHPGJS-së,

Pas diskutimeve të hollësishme me gjyqtarët e lartpërmendur,

Me këtë duke kufizuar kompetencat që i jepen atij nga dokumentet e përmendura,

**Kryetari i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për
çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**

Përmes vendimit lëshon me sa vijon

Rregullat mbi themelimin e Trupit Gjykues dhe Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, mbi Ndarjen e Lëndëve dhe Rregulloren e Plotësuar të Punës

I. Struktura e Gjykatës

A. Trupi Gjykues

1. Themelimi i Trupit Gjykues

Në pajtim me UA 2008/6, nenet 12.2 dhe 12.3, themelohet një Trup Gjykues.

Ai përbëhet nga *Godwin Muscat Azzopardi, Anna Bednarek, Antoinette Lepeltier-Dure, Esma Erterzi dhe Piero Leanza*, si gjyqtarë ndërkombëtarë, dhe *Gyltene Sylejmani* si gjyqtare që është banore e përherershme e Kosovës.

Trupi Gjykues ulet në grupe gjyqtarësh (RE 2008/4, Neni 3.2) i përbërë si vijon, i kryesuar nga gjyqtari i parë i përmendur:

Godwin Muscat Azzopardi, Piero Leanza dhe Gyltene Sylejmani (Grupi D)

Godwin Muscat Azzopardi, Anna Bednarek dhe Gyltene Sylejmani (Grupi F)

Anna Bednarek, Antoinette Lepeltier-Durel dhe *Gyltene Sylejmani* (Grupi H)

Antoinette Lepeltier-Durel, Esma Erterzi Ozkan dhe *Gyltene Sylejmani* (Grupi I)

Esma Erterzi, Piero Leanza dhe *Gyltene Sylejmani* (Grupi J)

Piero Leanza, Anna Bednarek dhe *Gyltene Sylejmani* (Grupi K)

Grupet A, B, C, E, G, të themeluara më 24 shkurt 2009, nuk ekzistojnë më.

2. Në rast të mungesës së përkohshme, përjashtimit apo pamundësisë për të ushtruar detyrën, zbatohen rregullat e mëposhtme:

Gjyqtari ndërkombëtar zëvendësohet, përmes vendimit të Kryetarit, nga një prej gjyqtarëve tjerë ndërkombëtar që nuk ulet tashmë në trupin gjykues. Kjo do të bëhet në mënyrë rotative sipas radhitjes alfabetike të mbiemrit, duke filluar me *Godwin Muscat Azzopardi*.

Për momentin, derisa të emërohet një gjyqtar tjetër vendor, *Gyltene Sylejmani* nuk do të zëvendësohet.

B. Kolegji i Ankesave

Më këtë themelohet një Kolegji i Ankesave. Ai përbëhet nga Kryetari i DHPGJS-së, *Richard Winkelhofer*, si gjyqtar kryesues i kolegit, Nënkyetari *Torsten Koschinka* dhe *Eija-Liisa Helin* si gjyqtarë ndërkombëtar, dhe *Gyltene Sylejmani* si gjyqtare që është banore e përhershme e Kosovës.

Në rast të mungesës së përkohshme, përjashtimit apo pamundësisë së gjyqtarëve të ankesave për të ushtruar detyrën, Kryetari mund të caktojë një nga gjyqtarët e shkallës së parë që të qëndrojë përkohësisht në Kolegin e Ankesave, nëse ai gjyqtar i shkallës së parë nuk ka marrë pjesë në aktvendimin e kundërshtuar të Trupit Gjykues. Kjo do të bëhet në mënyrë rotative sipas radhitjes alfabetike të mbiemrit, kështu që duke filluar me *Godwin Muscat Azzopardi*.

Në rast të mungesës së përkohshme apo pamundësisë së Kryetarit për të ushtruar detyrën, Nënkyetari *Torsten Koschinka* do të kryesojë Kolegin e Ankesave dhe, përveç nëse vendoset ndryshe nga Kryetari, do të ushtrojë funksionin e Kryetarit (UA 2008/6 Neni 8). Nënkyetari *Torsten Koschinka* zëvendësohet, sipas nevojës, nga *Eija-Liisa Helin*.

II. Ndarja e lëndëve (në pajtim me UA 2008/6 Neni 10.1[b])

A. Ndarja e lëndëve mes gjyqtarëve përgjegjës të Trupit Gjykues

1. Lëndët, pa marrë parasysh natyrën e tyre ligjore, përfshirë edhe kërkesat për ndalime të përkohshme, lëndët e ankesave sipas RE 2008/4 nenit 4.2 dhe kërkesat sipas RE 2008/4 nenit 4.6, ende të pazgjidhura nga dita e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave

- a. Të gjitha lëndët të cilat tashmë u janë caktuar *Godwin Muscat Azzopardit*, *Anna Bednarekut*, *Piero Leanzas* dhe *Gyltene Sylejmanit*, në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, do të mbisin tek ata. Lëndët që i janë caktuar *Muhamed Shalës* deri më 23 prill 2009 dhe referatit të tij të hapur deri në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, i ricaktohen *Esma Erterzi*. Të gjitha lëndët që i janë caktuar *Olavi Snellmanit* i ricaktohen *Antoinette Lepeltier-Durelit*.
- c. Për lëndët që nuk i janë caktuar ndonjë gjyqtari deri në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, do të zbatohet rregulla II.A.2.

2. Lëndët që janë parashtruar pas datës së hyrjes në fuqi të këtyre rregullave

Këto lëndë do të shpërndahen mes gjyqtarëve të shkallës së parë tek gjyqtari përgjegjës në mënyrë rotative si në vijim:

1. *Godwin Muscat Azzopardi*

2. *Anna Bednarek*

3. *Antoinette Lepeltier-Durel*

4. *Esma Erterzi*

5. *Piero Leanza*

6. *Godwin Muscat Azzopardi*

7. *Anna Bednarek*

8. - ∞. etc.

B. Ndarja e lëndëve mes grupeve të Trupit Gjykues

Lëndët që i janë caktuar tashmë *Godwin Muscat Azzopardit*, *Anna Bednarekit*, *Piero Leanzas* dhe *Gyltene Sylejmanit*, në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, mbisin me grupin tashmë të identifikuar në sistemin e mëparshëm të ndarjes së lëndëve të krijuar më 24 shkurt 2009, përveç nëse parashihet ndryshe në paragrafët vijues.

Në bazë të rregullave të lartpërmendura, lëndët e reja që i janë caktuar *Godwin Muscat Azzopardit* me numrat e fundit tek të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **D**, me numrat e fundit çift të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **F**.

Në bazë të rregullave të lartpërmendura, lëndët e reja që i janë caktuar *Anna Bednarekit* me numrat e fundit tek të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **H**, me numrat e fundit çift të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **K**.

Në bazë të rregullave të lartpërmendura, lëndët e reja që i janë caktuar *Piero Leanzas* me numrat e fundit tek të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **J**, me numrat e fundit çift të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **K**.

Në bazë të rregullave të lartpërmendura, lëndët e reja që i janë caktuar *Antoinette Lepeltier-Durelit* me numrat e fundit tek të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **H**, me numrat e fundit çift të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **I**.

E njëjtë rregull zbatohet për lëndët që më parë i ishin caktuar *Olavi Snellman* dhe të ricaktuara *Antoinette Lepeltier-Durelit* (II.A.1.a).

Në bazë të rregullave të lartpërmendura, lëndët e reja që i janë caktuar *Esma Erterzi* me numrat e fundit tek të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **I**, me numrat e fundit çift të numrit të lëndës bien në juridikcionin e grupit **J**.

E njëjtë rregull zbatohet për lëndët që më parë i ishin caktuar *Muhamed Shalës* apo referatit të tij të hapur deri në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave.

Kundërpaditë caktohen në pajtim me paditë të cilave u përkasin.

C. Ndarjet e lëndëve për ankesat kundër aktgjykimeve ose aktvendimeve të Trupit Gjykues

Lëndët e ankesave – pavarësisht nga natyra e tyre, duke përfshirë ankesat kundër ndalimeve të përkohshme – shpërndahen mes gjyqtarëve ndërkombëtar të Kolegjit të Ankesave në mënyrë rotative si vijon:

1. *Eija-Liisa Helin*
2. *Torsten Koschinka*
3. *Richard Winkelhofer*
4. *Eija-Liisa Helin*
5. *Torsten Koschinka*
6. - ∞. etc.

Ankesat në lëndët në të cilat tashmë është bërë ankesë para Kolegjit të Ankesave caktohen sipas këtyre ankesave të mëparshme.

Lëndët e mundshme për rishikim ("SCC-R, shih nenin 13.4 UA 2006/17) lidhur me aktvendimet e DHPGJS-së të marra para 31 dhjetorit 2008, do t'i nënshtrohen gjithashtu juridiksonit të kolegjit të ankesave.

D. Dispozitat e veçanta

Në interes të një pune efektive, dhe në pajtim me Praktikat Më të mira Evropiane dhe me Standardet Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, dhe duke marre parasysh parimet e shpërndarjes së barabartë të volumit të punës, Kryetari mundet, për arsyе të bazuara, të shmanget nga rregullat e lartpërmendura.

Arsyet e bazuara që lejojnë një shmangje të tillë mund të jenë:

- Lëndët që kanë lidhje për shkak të paraqitjes së palëve të njëjta nga njëra apo të dyja anët;
- Lëndët që kanë lidhje për shkak të përbajtjes së njëjtë faktike dhe ligjore;
- Arsyë të ngjashme.

IV. Hyrja në fuqi dhe publikimi

Këto rregulla hyjnë në fuqi më 8 qershor 2009 dhe janë të vlefshme deri më 31 dhjetor 2010.

Këto mund të ndryshohen nëse autorizohen nga rrethana të veçanta.

Pjesët I, II dhe IV të këtij dokumenti do të publikohen nga Regjistruesi Ndërkombëtar.